

b

Gusht 2025

ulletin ■

EU  NATURE

Buletini periodik
No. 1, gusht 2025

© eu4nature



Përmbajtja



BULETINI I EU4NATURE

- 01 EDITORIAL

- 02 EKIPET E ZONA TË MBROJTURA TË SHQIPËRISË FORCOJNË AFTËSITË PËRMES E-MËSIMIT INTERAKTIV: EU4NATURE ORGANIZOI TRAJNIM KOMBËTAR NË TIRANË

- 03 LUMI VJOSA, NJË ZONË PILOTE E EU4NATURE NË PRAG TË NJOHJES NGA UNESCO

- 04 PORTO PALERMO, NJË SIT PILOT I EU4NATURE PËR RESTAURIMIN DETAR DHE EKOTURIZMIN E QËNDRUESHËM

- 05 PARKU NATYROR “BREDHI I SOTIRËS”, – NGA MONUMENT NATYRE NË ZONË PILOT PËR MENAXHIM TË QËNDRUESHËM

- 06 PROBABILITETI I NJË TREGU TË KREDITEVE TË BIODIVERSITETIT NË SHQIPËRI

- 07 METT– METODË GLOBALE PËR VLERËSIMIN E EFEKTIVITETIT TË MENAXHIMIT TË ZONAVE TË MBROJTURA

- 08 TEKNOLOGJI PËR NATYRËN

Jemi të kënaqur të lançojmë Buletinin e parë EU4Nature, një botim elektronik tremujor në anglisht dhe shqip, të prodhuar në kontekstin e projektit EU4Nature, të financuar nga Bashkimi Evropian dhe Suedia, dhe të zbatuar nga UNDP, AICS dhe Ministria e Turizmit dhe Mjedisit e Shqipërisë. Ky buletin shërben si një platformë jetësore për të ndarë përditësime mbi përpjekjet e ruajtjes, njohuritë shkencore dhe sfidat në menaxhimin e zonave të mbrojtura të Shqipërisë.

Projekti EU4Nature mbështet Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, Agjencinë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura dhe Administratat Rajonale në ruajtjen e ekosistemeve jetësore, duke avancuar njëkohësisht qëllimet e integritetit të Shqipërisë në BE dhe Axiendën e Gjellbër të BE-së për Ballkanin Perëndimor. Duke ndihmuar në transpozimin e Direktivave të BE-së për Shpendët dhe Habitatet dhe duke u përafuar me Planin Kombëtar për Integritimin Evropian, EU4Nature forcon kornizën mjedisore të Shqipërisë. Ne ftojmë profesionistët e biodiversitetit dhe ruajtjes të kontribuojnë me ekspertizën e tyre, duke nxitur bashkëpunimin për të përmirësuar menaxhimin e parqeve kombëtare dhe monumenteve kulturore. Falënderimet tona të përzemërta shkojnë për të gjithë partnerët për përkushtimin e tyre në balancimin e ruajtjes së natyrës me zhvillimin e qëndrueshëm. Reagimet tuaja janë të paçmueshme për të siguruar që Buletini EU4Nature të mbetet një burim kyç për të gjithë palët e interesuara.

PËRMBLEDHJE E PROJEKTIT EU4NATURE

EU4Nature, i financuar nga Bashkimi Evropian dhe Qeveria Suedeze [1] dhe i zbatuar nga UNDP dhe AICS, synon të mbrojë dhe ruajë 25% të tokës dhe detit të Shqipërisë deri në vitin 2030 përmes një sistemi efektiv të Zonave të Mbrojtura (ZM), duke përfshirë vendet NATURA 2000. Projekti forcon kornizat institucionale dhe përparon transpozimin e Acquis të BE-së për Mbrojtjen e Natyrës duke rritur kapacitetet e autoriteteve në hartimin dhe menaxhimin e ZM-ve. Ai ofron asistencë teknike për të rishikuar Ligjin për Zonat e Mbrojtura, për të përcaktuar rolin e Fondit Special për Zonat e Mbrojtura, ndërsa mbështet legjislacionin dytësor për të siguruar pajtueshmërinë përmes masave të forta zbatuese.

EU4Nature përmirëson menaxhimin e ZM-ve ekzistuese dhe të reja duke përditësuar planet e menaxhimit, duke krijuar Sisteme të Monitorimit të Performancës dhe duke i dhënë përparësi aktiviteteve të ruajtjes dhe restaurimit. Ai promovon menaxhimin e qëndrueshëm të habitateve, specieve dhe produkteve pyjore prioritare. Përveç kësaj, projekti fuqizon organizatat e shoqërisë civile shqiptare përmes një Programi të Granteve të Vogla, duke mbështetur veprime pilot inovative, Zgjidhje të Bazuara në Natyrë dhe masa për të luftuar krimin mjedisor. Në përputhje të plotë me objektivat strategjike të Shqipërisë, EU4Nature nënvizon rolin e biodiversitetit në arritjen e zhvillimit të qëndrueshëm.

[1] Përkatësisht, nëpërmjet "Kornizës Programore të Instrumentit të Veprimit për Ndihmën Para-Anëtarësuese (IPA III) për periudhën 2021-2027" W 3 - Axienda e Gjellbër dhe Konektiviteti i qëndrueshëm - TP 1 - Mjedisit dhe ndryshimet klimatike

EKIPET E ZONAVE TË MBROJTURA TË SHQIPËRISË FORCOJNË AFTËSITË PËRMES E-LEARNING INTERAKTIV: EU4NATURE ORGANIZON TRAJNIMIN KOMBËTAR NË TIRANË

Tiranë, 28 maj 2025, Projekti EU4Nature, në partneritet me Agjencinë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura (AKZM), organizoi një trajnim dinamik njëditor me përgjegjësit e sektorit të menaxhimit nga 12 qarqe të Shqipërisë. I mbajtur në sallën "InNature" në simbolin e Tiranës, Piramidën, aktiviteti synoi të forcojë kapacitetet e atyre që janë në vijën e parë të mbrojtjes së natyrës përmes mjeteve novatore të të nxënës dhe bashkëpunimit rajonal.

Në qendër të trajnimit ishte kursi "Hyrje tek natyra, biznesi dhe financa", pjesë e platformës ndërkombëtare "Learning for Nature", tashmë tërësisht i disponueshëm në gjuhën shqipe falë mbështetjes së EU4Nature. Ky kurs prezanton koncepte kyçe si vlera ekonomike e natyrës, rreziqet dhe mundësitë mjedisore, si dhe lidhjet midis ekosistemeve, biznesit të qëndrueshëm dhe financave.

"Kjo platformë është një mjet shumë i fuqishëm. Fakti që tashmë ofrohen edhe kurse në shqip e bën të aksesueshme për profesionistët e mjedisit, partnerët lokalë dhe studentët në mbarë vendin," u shpreh një pjesëmarrës. Ekipi i EU4Nature udhëzoi pjesëmarrësit për përdorimin e platformës, duke i ndihmuar të regjistrohen, të lundrojnë në faqe dhe të përfundojnë disa module gjatë workshopit. Ushtrimet praktike në grup dhe diskutimet forcuuan përmbajtjen e kursit, duke inkurajuar një adaptim lokal të materialit.

Trajnimi theksoi:

- Rëndësinë e natyrës në planifikimin dhe zhvillimin ekonomik
- Mënyrat për të vlerësuar rreziqet dhe mundësitë që lidhen me natyrën
- Domosdoshmërinë e integritetit të konsideratave mjedisore në vendimarrje

Gjatë trajnimit u vu re një angazhim i lartë dhe pjesëmarrje aktive nga të pranishmit, ku shumë pjesëmarrës u angazhuan të promovojnë kursin tek ekipet dhe institucionet lokale. Si hap i radhës, ata do të vijnë kursin online dhe do të dorëzojnë certifikatat e përfundimit të kursit ekipit të EU4Nature.




KURSI ËSHTË I HAPUR PËR KËDO

Kursi është i hapur për të gjithë, punonjësit që kontribuojnë në mbrojtjen e mjedisit, aktorët lokalë, studentët dhe profesionistët që dëshirojnë të thellojnë njohuritë mbi ndërthurjen midis natyrës dhe financave të qëndrueshme.



[Regjistrohu këtu: – An Introduction to Nature, Business and Finance](#)



I shtrirë 272 kilometra nga malet Pindus të Greqisë deri në brigjet e Adriatikut të Shqipërisë, lumi Vjosa, një zonë pilot e projektit EU4Nature, është një nga lumenjtë e fundit të egër dhe me rrjedhë të lirë të Evropës. Në mars të vitit 2023, Shqipëria e shpalli Vjosën dhe degët e saj Park Kombëtar, i pari i këtij lloji në Evropë.

Tashmë e njohur globalisht si një zonë e mbrojtur, Vjosa është në prag të bashkimit me rrjetin e Rezervës së Biosferës të UNESCO-s, proces i udhëhequr nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe Agjencia Kombëtare për Zonat e Mbrojtura në bashkëpunim me ekspertë nga Unioni Ndërkombëtar për Ruajtjen e Natyrës dhe partnerë ndërkombëtarë, duke shënuar kështu një kapitull të ri në ruajtjen globale të lumenjve.

Ky nominim i radhës është më shumë se simbolik. Ai do të forcojë mbrojtjen në të gjithë Luginën e Vjosës, duke ruajtur integritetin e saj të pasur ekologjik nga burimi në det. Deri më sot, në pellgun e Vjosës njihen gjithsej 1,687 specie, 653 specie bimore dhe 1,034 specie shtazore, duke përfshirë shumë specie të kërcënuara dhe endemike në nivel evropian dhe global. Korridori lumor gjithashtu strehon një nga përqendrimet më të larta të habitateve të rrezikuara të fushave të përmytjeve të mbrojtura sipas Direktivës së BE-së për Habitatet.

Ndryshe nga shumica e lumenjve evropianë, të fragmentuar nga më shumë se një milion diga dhe barriera, Vjosa rrjedh lirisht përmes grykave, ligatinave dhe një delte pothuajse të paprekur. Dinamika e saj natyrore, si transporti i pandërprerë i sedimenteve dhe përmytjet sezonale, mbështesin një gamë të gjerë të jetës dhe ofrojnë qëndrueshmëri thelbësore ndaj klimës.

Statusi i Rezervës së Biosferës së UNESCO-s do të forconte mbrojtjet ekzistuese dhe do të nxiste një kuadër ligjor dhe institucional që mbështet zhvillimin e qëndrueshëm. Kjo përfshin bujqësinë me ndikim të ulët, ruajtjen e biodiversitetit dhe mjetet e jetesës lokale, të gjitha të integruara brenda një peizazhi rezistent ndaj klimës.

EU4Nature, një partner kryesor në këtë përpjekje, e ka identifikuar Parkun Kombëtar të Vjosës si një vend pilot kryesor. Projekti mbështet restaurimin e habitateve, monitorimin e biodiversitetit dhe ndërtimin e kapaciteteve për stafin e zonave të mbrojtura, duke siguruar mbrojtje afatgjatë që është e rrënjësuar si në shkencë ashtu edhe në komunitet.

NJË MODEL I RI PËR ADMINISTRIMIN E LUMENJVE

Statusi i Rezervës së Biosferës së UNESCO-s është një përcaktim i dhënë nga Organizata e Kombeve të Bashkuara për Arsim, Shkencë dhe Kulturë (UNESCO) në kuadër të Programit të saj Njeriu dhe Biosfera. Ky status u jepet zonave që demonstrojnë një marrëdhënie të ekuilibruar midis ruajtjes së biodiversitetit, zhvillimit të qëndrueshëm dhe mbështetjes logjistike për kërkimin dhe arsimin.

Vendimi përfundimtar i UNESCO-s për statusin e Rezervës së Biosferës së Vjosës pritet në shtator 2025. Deri atëherë, vrulli vazhdon të ndërtohet në të gjithë politikën, shoqërinë civile dhe komunitetet lokale.

Lumi Vjosë është tashmë një sistem lumor i mbrojtur, por e ardhmja e tij si Rezervë Biosfere e UNESCO-s do të vendoste një precedent global. Është një model i gjallë se si njerëzit dhe natyra mund të lulëzojnë së bashku.



ÇFARË PO BËN EU4NATURE PËR VJOSËN

EU4Nature po luan një rol të rëndësishëm në mbështetjen e integritetit ekologjik, kapacitetit institucional dhe menaxhimit të qëndrueshëm të Parkut Kombëtar të Lumit Vjosa. Vendndodhja u zgjodh si një nga 10 zonat e mbrojtura pilot në kuadër të EU4Nature, duke pasur parasysh statusin e saj si Park Kombëtar (VKM nr. 155, datë 13.3.2023) dhe një sipërfaqe prej 12,727 hektarësh. Aktivitetet kryesore do të përqendrohen në ruajtjen dhe restaurimin, monitorimin e biodiversitetit dhe ndërtimin e kapaciteteve.

EU4Nature po identifikon masat prioritare të ruajtjes dhe restaurimit për Parkun Kombëtar të Lumit Vjosa, të cilat përfshijnë restaurimin e habitateve, mbështetjen për praktikatat tradicionale të përdorimit të tokës, përmirësimin e kushteve të punës dhe pajisje për stafin e zonave të mbrojtura.

Vjosa është pjesë e zhvillimit të të dhënave dhe hartëzimit GIS për sitet Natura 2000. Kjo përfshin inventarët e habitateve/specie dhe plotësimin e Formularëve Standardë të të Dhënave (SDF) sipas kërkesave të BE.

Projekti mbështet ndërtimin e kapaciteteve për stafin e AKZM/AdZM, përfshirë ata që menaxhojnë zonën e Vjosës, nëpërmjet platformave të mësimit elektronik dhe trainimeve mbi Direktivat e BE-së për Shpendët dhe Habitatet, vlerësimin e efektivitetit dhe monitorimin e specieve/habitateve, me qëllim sigurimin e ruajtjes afatgjatë bazuar në të dhëna shkencore, me mbështetjen e komuniteteve lokale.





PORTO PALERMO, NJË SIT PILOT I EU4NATURE PËR RESTAURIMIN DETAR DHE EKOTURIZMIN E QËNDRUESHËM

E pozicionuar përgjatë bregdetit jugor të Shqipërisë, Gjiri i Porto Palermos është një perlë e biodiversitetit dhe trashëgimisë. Sot, ky vend ndodhet në ballë të përpjekjeve për ruajtjen e biodiversitetit detar, falë përzgjedhjes si një sit pilot i projektit EU4Nature, i cili mbështet objektivin kombëtar të Shqipërië për të mbrojtur të paktën 25% të territorit të saj tokësor dhe detar.

Në maj 2025, një ekip ndërdisiplinor nga Universiteti i Gjenovës (departamentet DICCA dhe DiSTAV) realizuan një vëzhgim të detajuar në terren në Porto Palermo, me fokus në restaurimin e livadheve të posidonies dhe monitorimin e gjendjes së shkëmbinjëve artificiale (ARs). Kjo ekspertizë është në vijim të përpjekjeve të mëparshme të projektit NaturAlbania, të financuar nga AICS, duke zgjeruar njohuritë shkencore dhe themeleve të vendosura për zgjidhje të bazuara në natyrë (NBS) në këtë zonë.

Livadhet e leshterikëve të detit, veçanërisht ato të formuara nga *Posidonia oceanica*, janë ndër habitatet detare më produktive dhe me vlerë në Mesdhe. Megjithatë, në Porto Palermo, këto livadhe po degradohen për shkak të ankorimeve të pakontrolluara nga varkat turistike, veçanërisht gjatë pikut të sezonit turistik. Dëmet në fundin e detit dhe shkulja e posidonies kanë sjellë nevojën urgjente për ndërhyrje.

Për adresimin e këtij problemi, monitorimet në kuadër të projektit po kontribuojnë në identifikimin e zonave të përshtatshme për restaurimin e ardhshëm me *Posidonia oceanica*, mbi bazën e një propozimi teknik në përgatitje, i cili kombinohet me iniciativën për instalimin e bovave lundruese për ankorim ekologjik. Këto sisteme synojnë të parandalojnë dëmtimin e substratit detar nga zinxhirët e ankorimit, duke siguruar mbrojtjen e livadheve ekzistuese si dhe të atyre që do të restaurohen.

Në Porto Palermo gjenden tashmë 18 shkëmbinj artificialë të vendosura në vitin 2022 në kuadër të iniciativës NaturAlbania. Këto struktura nënujore strehojnë tashmë një komunitet të pasur detar, duke filluar nga peshq gështenjë dhe kern, te murenat dhe peshqit e familjes Labridae, duke demonstruar ndikimin e tyre pozitiv në biodiversitetin detar. Ekipi i Universitetit të Gjenovës realizoi censuse nënujore dhe hartëzime GIS për secilin shkëmb artificial, duke mbledhur të dhëna të rëndësishme për të vlerësuar stabilitetin dhe rolin e tyre ekologjik.



Përveç biodiversitetit, këto struktura artificiale kanë potencial të madh për ekoturizëm të qëndrueshëm. Dizajni dhe vlera estetike e tyre, të cilat mund të përmirësohen më tej me teknologjinë e printimit 3D, i bëjnë ideale për krijimin e shtigjeve nënujore për zhytësit. Iniciativa të tilla mund të ndihmojnë ta kthejnë Porto Palermon në një qendër të turizmit të përgjegjshëm detar, duke mbështetur të ardhurat lokale pa dëmtuar integritetin mjedisor.

Kombinimi i instalimit të bovave lundruese për ankorim, restaurimit të livadheve të posidonies dhe përmirësimit të shkëmbinjëve artificiale reflekton qasjen e integruar dhe të bazuar në shkencë të promovuar nga EU4Nature. Me mbështetje teknike nga partnerë italianë dhe shqiptarë, projekti po vendos një standard të ri për mënyrën se si zonat e mbrojtura detare mund të ruajnë biodiversitetin, të përballojnë presionet njerëzore dhe të nxisin qëndrueshmërinë ndaj ndryshimeve klimatike dhe turizmit të qëndrueshëm.

Iniciativa të tilla mund të ndihmojnë në transformimin e Porto Palermos në një qendër për turizmin detar të përgjegjshëm, duke mbështetur jetesën lokale pa e komprometuar integritetin mjedisor.

Ndërsa Porto Palermo ecën përpara si një sit pilot i EU4Nature, ai ofron një vizion të fuqishëm për mënyrën se si thesaret bregdetare të Shqipërisë mund të mbrohen, jo vetëm për sot, por edhe për brezat që do të vijnë.



PARKU NATYROR “BREDHI I SOTIRËS”, – NGA MONUMENT NATYRE NË ZONË PILOT PËR MENAXHIM TË QËNDRUESHËM

Parku natyror “Bredhi i Sotirës”, i vendosur në jug të Shqipërisë, në territorin e bashkisë Dropull, është një nga zonat më të veçanta për nga biodiversiteti dhe rëndësia ekologjike që përfaqëson. Dikur shpallur monument natyre, në janar 2022 zona u zgjerua dhe fitoi statusin e parkut natyror, duke hyrë zyrtarisht në një fazë të re të mbrojtjes dhe menaxhimit të burimeve të saj natyrore.

Me një sipërfaqe prej 4,927.67 ha, parku shtrihet në shpatet e maleve të Stugarës dhe Murganës, në një mozaik relievi që favorizon një gamë të gjerë ekosistemesh. Ai përfshin pyje relikte me bredhin e maqedonisë (*Abies borisii-regis*) dhe gështenjën e butë (*Castanea sativa*), ndërsa studime të fundit kanë ngritur hipotezën se në zonën faktikisht mund të gjendet bredhi i cefalonisë (*Abies cephalonica*). Në total, janë identifikuar 9 tipe habitatesh natyrore, lloje endemike dhe specie të Listës së Kuqe të IUCN. Territori i parkut është i ndarë në dy zona menaxhimi: Zona Qendrore (2,803.27 ha) dhe Zona e Përdorimit Tradicional dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm (2,124.4 ha).

Zona Qendrore përfshin zona me vlerë të lartë të biodiversitetit, duke përfshirë habitate relikte me pyje bredhi dhe gështenje. Kjo zonë i nënshtrohet masave të rrepta mbrojtëse, duke lejuar vetëm aktivitete me ndikim të ulët, siç janë kërkimi shkencor dhe ekoturizmi i bazuar në natyrë.

Në të kundërt, Zona e Përdorimit Tradicional dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm synon të ruajë praktikën tradicionale si bujqësia, kullotja dhe mbledhja e bimëve medicinale, duke siguruar përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore pa kompromentuar integritetin ekologjik të parkut.

Stafi i Administratës Rajonale për Zonat e Mbrojtura (RAPA) në Gjirokastrë, me mbështetjen e ekipit të projektit, kreu një analizë të kërcënimeve ekzistuese në Parkun Natyror “Bredhi i Sotirës” duke përdorur mjetin METT-4. Ky vlerësim fillestar shërben si bazë për të kuptuar situatën aktuale dhe për të udhëzuar ndërhyrjet prioritare për ruajtjen e vlerave natyrore të parkut, duke përfshirë habitatet e bredhit dhe gështenjës relikte, si dhe speciet e mbrojtura që banojnë në këtë ekosistem unik. Vlerësimi pritet të përmirësohet në mënyrë progresive në përputhje me rritjen e kapaciteteve administrative lokale dhe forcimin e mekanizmave të monitorimit dhe raportimit në terren.



Dy grafikët më poshtë ilustrojnë fushëveprimin dhe ashpërsinë e kërcënimeve të identifikuara gjatë vlerësimit. Shumica e kërcënimeve u vlerësuan nga të ulëta deri në të moderuara si në fushëveprim ashtu edhe në ashpërsi, megjithatë ato ende kërkojnë vëmendje të koordinuar për të parandaluar përshkallëzimin e ndikimeve të tyre në biodiversitet.

Kërcënimet kryesore të identifikuara në Parkun Natyror “Bredhi i Sotirës” përfshijnë kullotjen dhe blegtorinë, mbledhjen e bimëve të egra, ndotjen nga efluentet bujqësore, gjuetinë dhe zjarrvënien, të cilat ndikojnë mbi proceset ekologjike, biodiversitetin dhe cilësinë e habitateve. Menaxhimi dhe monitorimi i vazhdueshëm janë të nevojshme për të shmangur përshkallëzimin e këtyre ndikimeve.

Analiza tregon gjithashtu se disa kërcënime të mundshme, si speciet invazive, degradimi i habitatit për shkak të fragmentimit, etj, nuk janë ende të dokumentuara si rezultat i mungesës së informacionit.

Pavarësisht vlerave të padiskutueshme, parku natyror “Bredhi i Sotirës” përballet me sfida të konsiderueshme. Mungesa e një plani menaxhimi dhe kapacitetet administrative të kufizuara kanë penguar deri më tani zhvillimin e një qasjeje efektive për ruajtjen dhe përdorimin e qëndrueshëm të kësaj zone.

Në këtë kontekst, projekti EU për Natyrën, ka përfshirë parkun natyror “Bredhi i Sotirës” si një nga zonat pilot për ndërhyrje të drejtpërdrejta në përmirësimin e menaxhimit dhe ruajtjes së biodiversitetit.

Projekti synon:

- Hartimin e planit të parë të menaxhimit të parkut, duke vendosur një kornizë të qartë për mbrojtjen dhe përdorimin e qëndrueshëm të burimeve;
- Forcimin e kapaciteteve të stafit lokal përmes trajnimeve të specializuara në monitorim, ruajtje dhe menaxhim të integruar të territorit;
- Sigurimin e pajisjeve dhe infrastrukturës për monitorim dhe përmirësimin e kontrollit në terren.



Paraqitje grafike e rezultateve të vlerësimit të kërcënimeve për Parkun Natyror “Bredhi i Sotirës”
Vlerësimi METT 2024


Këto ndërhyrje do të krijojnë një model funksional menaxhimi për zonat e mbrojtura në jug të vendit, duke i hapur rrugë edhe veprimtarive të qëndrueshme si ekoturizmi dhe edukimi mjedisor në përputhje me objektivat e ruajtjes.

POTENCIALI PËR NJË TREG TË KREDITEVE TË BIODIVERSITETIT NË SHQIPËRI

Sipas “Aleancës për kreditet e biodiversitetit” (BCA), kreditë e biodiversitetit ofrojnë një mekanizëm të mundshëm për të financuar ruajtjen, restaurimin dhe ndërhyrjet që adresojnë faktorët kryesorë të humbjes së biodiversitetit, si degradimi dhe shkatërrimi i habitateve, mbishfrytëzimi dhe ndotja. Ato përfaqësojnë gjithashtu një mundësi për të aksesuar burime të reja financimi që mundësojnë ruajtjen e vlerave jetësore që natyra ofron përmes një game të gjerë shërbimesh të ekosistemit, përfshirë sekuestrimin e karbonit. Tregu vullnetar i krediteve të biodiversitetit, (Bloomberg NEF), kishte një vlerë rreth 8 milionë \$ në mesin e vitit 2023. Vlerësimet për rritjen potenciale të tregut të kredive të biodiversitetit variojnë nga 760 milionë deri në 2 miliardë dollarë në vitin 2030, dhe nga 6 deri në 69 miliardë dollarë në vitin 2050.

Ky mekanizëm mund të mbështesë shumë objektivave të lidhura me natyrën, duke ofruar instrumente me kosto-efikasitet të lartë për realizimin e synimeve për neutralitetin klimatik, neutralitetin e degradimit të tokës dhe objektivat e “Kuadrit Global për Biodiversitetin”. Sa më sipër, nevoja për projekte kreditesh të biodiversitetit është e qartë për të adresuar prioritetet dhe objektivat e përcaktuara në strategjitë kombëtare, të cilat janë të strukturuar për të pasqyruar objektivat globale.

Sipas përkufizimit aktual të BCA-së, një “kredit biodiversiteti” është një certifikatë që dëshmon një njësi të matshme, të verifikuar dhe të qëndrueshme të përfitimit real për biodiversitetin, përfitim që është shtesë ndaj gjendjes që do të kishte ekzistuar pa këtë ndërhyrje.





DETAILED RESULTS

Project name	Mainstreaming Biodiversity in Coastal Development and Planning for Sustainable Tourism Development		
Continent	Europe	Project duration (in years)	
Country	Albania	Implementation	4
Climate	Warm Temperate	Capitalization	16
Moisture	Dry	Period analysis	20

Total area (ha)	91,817
Mineral soil	91,817
Organic soil	0
Waterbodies	0

Global warming potential	
CO ₂	1
CH ₄	28
N ₂ O	265

GROSS FLUXES

In tCO₂-e over the whole period analysis

PROJECT COMPONENTS		WITHOUT	WITH	BALANCE
Land use changes	Deforestation	626,199	0	-626,199
	Afforestation	0	0	0
	Other land-use	-1,416,567	-1,452,890	-36,322
Cropland	Annual	0	0	0
	Perennial	0	0	0
	Flooded rice	0	0	0
Grasslands & Livestock	Grasslands	0	0	0
	Livestock	0	0	0
	Forest mngt.	0	0	0
Inland wetlands	Inland wetlands	0	0	0
	Coastal wetlands	137,527	0	-137,527
	Fisheries and aquaculture	0	0	0
Inputs & Invest.	Inputs & Invest.	0	0	0
Total emissions, tCO₂-e		-652,841	-1,452,890	-800,049
Total emissions, tCO₂-e/ha		-7.1	-15.8	-8.7
Total emissions, tCO₂-e/ha/yr		-0.4	-0.8	-0.4

SHARE PER GHG OF THE BALANCE

In tCO₂-e over the whole period analysis

CO ₂ BIOMASS	CO ₂ SOIL	N ₂ O	CH ₄	ALL NON-AFOLU EMISSIONS*
-626,199	0	0	0	
0	0	0	0	
18,244	-54,566	0	0	
0	0	0	0	
0	0	0	0	
0	0	0	0	
0	0	0	0	
0	0	0	0	
0	0	0	0	
0	0	0	0	
0	-137,527	0	0	
0	0	0	0	0
0	0	0	0	0
-607,955	-192,094	0	0	0
-6.6	-2.1	0.0	0.0	0.0
-0.3	-0.1	0.0	0.0	0.0

AVERAGE ANNUAL EMISSIONS

In tCO₂-e/yr

WITHOUT	WITH	BALANCE
31,310	0	-31,310
0	0	0
-70,828	-72,644	-1,816
0	0	0
0	0	0
0	0	0
0	0	0
0	0	0
0	0	0
0	0	0
6,876	0	-6,876
0	0	0

DETAILED MATRIX OF CHANGES FOR MINERAL SOILS

WITHOUT PROJECT	Forest	Annual	Perennial	Flooded rice	Grassland	Degraded land	Other land	Total area (ha)
Forest	46,705	0	0	0	0	0	1,198	47,903
Annual cropland	0	837	0	0	0	0	32,650	33,487
Agroforestry	0	0	80	0	0	0	3,138	3,218
Flooded rice	0	0	0	0	0	0	0	0
Grassland	0	0	0	0	178	0	6,926	7,104
Degraded land	0	0	0	0	0	0	0	0
Other land	0	0	0	0	0	0	105	105
Total area without project (ha)	46,705	837	80	0	178	0	44,017	91,817
WITH PROJECT	Forest	Annual	Perennial	Flooded rice	Grassland	Degraded land	Other land	Total area (ha)
Forest	47,903	0	0	0	0	0	0	47,903
Annual cropland	0	0	0	0	0	0	33,487	33,487
Agroforestry	0	0	0	0	0	0	3,218	3,218
Flooded rice	0	0	0	0	0	0	0	0
Grassland	0	0	0	0	0	0	7,104	7,104
Degraded land	0	0	0	0	0	0	0	0
Other land	0	0	0	0	0	0	0	0
Total area with project (ha)	47,903	0	0	0	0	0	43,809	91,712

Duke marrë parasysh zhvillimin e shpejtë aktual të tregut të krediteve të biodiversitetit dhe rritjen e mundshme në të ardhmen, është e rëndësishme që Shqipëria të vlerësojë dhe të kuptojë në ç'masë kreditë e biodiversitetit mund të ofrojnë burime të reja financimi për ruajtjen e natyrës brenda kufijve shtetëror. Vetëm pak vende në botë kanë legjislacion të veçantë për kreditë e biodiversitetit, Australia është një nga shembujt e rrallë, me legjislacionin e saj për "Restaurimin e natyrës" (2023). Në disa vende, ligjet dhe politikat qeveritare po zbatohen në mënyrë që të mund të rrisin kërkesën për kreditë e biodiversitetit. Për shembull, rregullorja e Mbretërisë së Bashkuar për Fitimin Neto të Biodiversitetit, kërkon që zhvilluesit të tregojnë një rritje neto të biodiversitetit përpara se të marrin lejen e ndërtimit (që hyn në fuqi në fund të vitit 2023). BE miratoi direktivën për restaurimin e natyrës në qershor 2023.

Total area (ha) 91,817

Mineral soil	91,817
Organic Soil	0
Waterbodies	0

Zhvillimi i tregjeve të krediteve të biodiversitetit në nivel kombëtar përfshin konsiderata të rëndësishme ligjore që lidhen me të drejtat e përdorimit të burimeve dhe pronësinë e tokës, si dhe aftësinë për të lidhur dhe zbatuar kontrata afatgjata. Projektet e krediteve të karbonit dhe biodiversitetit zakonisht zgjasin 20–30 vjet. Në nivel kombëtar, ekzistojnë shpesh mekanizma të ndryshëm ligjorë që mund të zbatohen në kontekstin e zhvillimit dhe shitjes së krediteve të biodiversitetit, si: marrëveshjet për qiradhënie e pyjeve komunale, koncesionet e gjuetisë dhe qiraja e kullotave.

Është e nevojshme që Shqipëria të dijë se cilat janë boshllëqet apo barrierat kryesore që mund të pengojnë pjesëmarrjen në tregun e krediteve të biodiversitetit, veçanërisht në lidhje me politikat, ligjet dhe rregulloret kombëtare, si dhe boshllëqet e tjera të kapaciteteve teknike. Po ashtu, është e rëndësishme të kuptohet se cilat mund të jenë përfitimet potenciale nga pjesëmarrja në këtë treg. Së fundi, nëse synohet, është e nevojshme të identifikohen hapat që duhen ndërmarrë për të nxitur me sukses zhvillimin dhe tregtimin e krediteve të biodiversitetit. Tregu i krediteve të biodiversitetit në shumë aspekte ndërtohet mbi përvojën ekzistuese të rregulloreve të krediteve të karbonit, dhe do të jetë thelbësore të mësohet nga gabimet e tregut të karbonit (p.sh. sigurimi i integritetit, shpërndarja e fondeve në nivel lokal, transparenca, mbështetja e synuar nga qeveria, përfshirë ministritë e financave, të mjedisit etj.).

Autoritetet dhe institucionet shkencore përkatëse është e nevojshme të angazhohen për të vlerësuar të gjitha mjetet dhe fushat kryesore brenda kontekstit kombëtar, që do të ishin të rëndësishme për zhvillimin e skemave të besueshme dhe të drejta të krediteve të biodiversitetit.

Një punë e tillë duhet të evidentojë pikat e forta dhe mundësitë për pjesëmarrjen potenciale në tregun e krediteve të biodiversitetit, dobësitë dhe kërcënimet e mundshme që lidhen me angazhimin në këtë treg dhe masën në të cilën ekziston një mjedis mbështetës i mjaftueshëm për të ndihmuar zhvillimin dhe tregtimin e krediteve të biodiversitetit në tregun kombëtar dhe ndërkombëtar, me standard të lartë cilësie dhe integriteti.


Në kuadër të fazës përgatitore për zhvillimin e një projekti GEF (2021–2022), u krye një vlerësim shumë i kufizuar për të vlerësuar situatën. Ky proces u mbështet me diskutime dhe një analizë më të detajuar me ekspertët e GIS, sa i përket mbulesës së tokës në zonat e mbrojtura, si dhe ndarjes së disa pritshmërive ose normave që mund të aplikoheshin në një ushtrim të tillë.

Është fakt që ka një pjesëmarrje shumë të kufizuar, pothuajse inekzistente, të organizatave apo institucioneve shqiptare në tregun ndërkombëtar të karbonit përmes shitjes apo tregtimit të krediteve të karbonit; megjithatë, me mbështetjen e UNDP-së, në fund të vitit 2009 u hartua “Strategjia kombëtare për financimin e karbonit”, dhe struktura e përgjithshme dhe qasja e saj mund të jenë të përshtatshme për të zhvilluar një produkt të ngjashëm në lidhje me kreditë e biodiversitetit.

EX-ACT tool, një mjet shumë i dobishëm për llogaritjet, u përdor me mbështetjen ndërkombëtare gjatë GEF 7 (2021–2022). Ai u miratua si i vetmi mjet i llogaritjes së gazeve serrë që mbulon të gjithë sektorin bujqësor, për të vlerësuar llogaritjet e karbonit për treguesin CO₂ eq, përfshirë bujqësinë, pyjet dhe përdorimet e tjera të tokës (AFOLU), zonat ligatinore bregdetare dhe të brendshme, peshkimin dhe akuakulturën, inputet bujqësore dhe infrastrukturën. Kjo bazohej në të dhënat e ofruara për mbulesën e tokës në zonat kyçe për Biodiversitetin (KBA) në Shqipëri. Kursimi total potencial i karbonit (për 20 vite) nga sektori AFOLU vlerësohet në 800,049 t CO₂ eq. Natyrisht, ka hapësirë për të përpunuar më tej supozimet e aplikuara, nëse është e nevojshme, por në parim mjeti EX-ACT i ka shërbyer qëllimit.

Vendet që hedhin hapat e parë drejt zhvillimit të tregut të krediteve të biodiversitetit do të jenë të pozicionuara më mirë për të përfituar një pjesë më të madhe të këtij tregu për ruajtjen e natyrës brenda kufijve të tyre. Në çdo rast, ndërgjegjësimi dhe ndërtimi i kapaciteteve nuk është një proces i shpejtë dhe i lehtë, por është e rëndësishme të fillojë diskutimi.


METT- METODË GLOBALE PËR VLERËSIMIN E EFEKTIVITETIT TË MENAXHIMIT TË ZONAVE TË MBROJTURA



Përqindja e sipërfaqes së mbuluar nga zonat e mbrojtura me vlerësime të efektivitetit të menaxhimit në nivel kombëtar. Mbulesa tregohet si për zonat tokësore dhe ujërat e brendshme, ashtu edhe për zonat detare. Burimi: UNEP-WCMC dhe IUCN 2024.

Vlerësimi i Efektivitetit të Menaxhimit (METT) është një instrument ndërkombëtar i zhvilluar nga WWF dhe Banka Botërore në vitin 2002 për të gjykuar në mënyrë të strukturuar mbi efektivitetin e menaxhimit të zonave të mbrojtura. I harmonizuar me Kornizën e IUCN për Vlerësimin e Efektivitetit të Menaxhimit të Zonave të Mbrojtura (PAME), METT është aplikuar në më shumë se 120 vende dhe mbi 4000 zona të mbrojtura në mbarë botën, si standard global për monitorimin e performancës. Versioni me I fubndit METT-4, u publikua në vitin 2020.

METT është një mjet praktik dhe fleksibël që përdoret gjerësisht për të matur progresin në kohë të efektivitetit të menaxhimit të zonave të mbrojtura. METT është i shpejtë, nuk kërkon përfshirjen e konsulentëve të shtrenjtë dhe ofron një vlerësim cilësor të bazuar në ndershmërinë dhe përvojën e vetë menaxherëve. Parimi bazë i METT është se menaxhimi i mirë i një zone të mbrojtur ndjek një proces të strukturuar me gjashtë faza: Së pari, kuptimi i statusit të vlerave kryesore dhe kërcënimeve; së dyti, planifikimi i masave prioritare; së treti, alokimi i burimeve (inputeve); së katërti, zbatimi i aksioneve menaxhuese (proceset); së pesti, realizimi i produkteve dhe shërbimeve konkrete (outpute); dhe në fund, vlerësimi i impakteve dhe rezultateve në terren. Ky cikël i plotë ndihmon në monitorimin e progresit, identifikimin e boshllëqeve, forcimin e llogaridhënies dhe orientimin e ndërhyrjeve për ruajtjen efektive të natyrës dhe biodiversitetit.




Korniza e IUCN WCPA për vlerësimin e efektivitetit të menaxhimit të zonave të mbrojtura
(Burimi: Hockings et al. 2006)

Në Shqipëri, METT-4 po përqafohet si një mjet standard për të monitoruar menaxhimin e zonave të Mbrojtura. EU4Nature po mbështet përpjekjet për institucionalizimin e këtij mjeti, duke realizuar trajnime të vazhdueshme të stafit të zonave të mbrojtura dhe duke zhvilluar një platformë digjitale për regjistrimin e të dhënave (akzm.net). Procesi i vlerësimit po ndiqet në 10 zonat pilot, përfshirë Parkun Kombëtar Lumi i Vjosës, Lurë-Mali i Dejës, Mali i Dajtit, Shebenik, Bredhi i Hotovës-Dangëlli, etj, METT-4 është duke u përdorur gjerësisht edhe nga organizata të tjera në Shqipëri për qëllime vlerësimi dhe raportimi, duke konsoliduar rolin e tij si standard kombëtar.

Si pjesë e këtij procesi, janë organizuar trajnime me stafet e 12 AdZM-ve dhe të AKZM-së, duke ndërtuar kapacitete praktike për zbatimin dhe raportimin mbi METT-4. Stafi është trajnuar në mënyrën e vlerësimit të secilës prej 38 pyetjeve të METT, dokumentimin e argumenteve mbështetëse dhe interpretimi i rezultateve me qëllim orientimin e përmirësimeve në menaxhim.

Bazuar në vlerësimet e para të realizuara gjatë vitit 2024, dolën në pah nivelet aktuale të performancës së menaxhimit për një sërë zonash të mbrojtura në Shqipëri. Siç tregon grafiku, analiza sipas komponentëve tregon se inputet (burimet njerëzore dhe financiare) janë më të ulëtat, proceset (si planifikimi, patrullimi dhe përfshirja e komuniteteve) kanë rezultate më të mira, ndërsa rezultatet ekologjike kërkojnë monitorim më të avancuar dhe afatgjatë. “Planifikimi” ka një pikëzim relativisht të mirë në zona si Mali i Dajtit, Lumi i Vjosës dhe “Shebenik”, të cilët kanë plane menaxhimi të miratuara, ndërkohë që situata paraqitet ndryshe për zonat që nuk e kanë ende këtë instrument bazë.

Rekomandimet e para nga ky vlerësim përfshijnë: përditësimin e planeve të menaxhimit në përputhje me gjetjet e METT, sigurimin e një buxhetimi të dedikuar për të adresuar boshllëqet e identifikuara; monitorimi i performancës, krijimin e një cikli të rregullt trajnimesh për stafin përgjegjës, etj.



Ky vlerësim i parë vjen si një pikënisje e rëndësishme për përmirësimin e vazhdueshëm të menaxhimit të zonave të mbrojtura, duke lidhur më mirë planifikimin strategjik me inputet e nevojshme dhe me rezultatet konkrete në ruajtjen e vlerave natyrore, shërben si bazë referimi për matjen e progresit në vitet e ardhshme dhe për të orientuar përgatitjen dhe përditësimin e planeve të menaxhimit dhe lidhjen e tyre me objektivat e rrjetit Natura 2000.



Zhvillimi i një sistemi të qëndrueshëm dhe të bazuar në të dhëna shkencore për monitorimin e zonave të mbrojtura është një komponent thelbësor në ruajtjen afatgjatë të biodiversitetit.

Në këtë kuadër, sondat multiparametrike po kthehen në një prej teknologjive më të rëndësishme që po përdoren për të mbështetur vendimmarrjen dhe për të forcuar kapacitetet teknike të menaxherëve të zonave të mbrojtura ku gjenden ekosisteme ujore.

Këto pajisje mundësojnë matjen simultane dhe të saktë të një game të gjerë parametrash të cilësisë së ujit, përfshirë temperaturën, pH-in, oksigjenin e tretur, konduktivitetin, turbiditetin dhe potencialin oksidim-reduktim (ORP). Të dhënat e gjeneruara janë thelbësore për vlerësimin e ndikimeve mjedisore, për identifikimin e tendencave ekologjike dhe për marrjen e masave të rehabilitimit.

SONDAT MULTIPARAMETRIKE – TEKNOLOGJIA NË FUNKSION TË MONITORIMIT TË PARAMETRAVE NË EKOSISTEMET UJORE

Ekzistojnë dy lloje kryesore të sondave multiparametrike që përdoren në praktikën e monitorimit mjedisor:

- Sondat fikse, të cilat instalohen në pika të caktuara të monitorimit dhe transmetojnë të dhëna në kohë reale përmes rrjeteve celulare ose satelitore. Këto janë ideale për monitorim afatgjatë dhe të pandërprerë në zona të ndjeshme ose me vlera të veçanta natyrore.
- Sondat e lëvizshme (portative), që përdoren nga ekipet teknike për matje të shpejta dhe të përsëritura në pika të ndryshme, pa nevojën për infrastrukturë të përhershme. Ato janë të lehta për t'u transportuar dhe operuar në terrene të vështira, duke ofruar një mjet praktik për reagim të menjëhershëm dhe monitorim të përqendruar.



Në kuadër të **projektit EU4Nature**, janë siguruar pesë sonda multiparametrike të lëvizshme për Agjencinë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura (AKZM), të cilat janë tashmë në përdorim nga AdZM Vlorë e cila mbulon një larmishmëri të zonave të mbrojtura me ekosisteme ujore, zonat e mbrojtura detare të “Karaburun-Sazanit” dhe “Porto Palermos”, Parkun Kombëtar “Lumi Vjosa”, PK Butrint etj. Pajisjet kanë për qëllim të rrisin kapacitetin për monitorim të decentralizuar në zona me akses të kufizuar apo në kushte të ndryshme natyrore.

Në vendin tonë, kjo teknologji është pilotuar më parë nga UNDP në Parkun Kombëtar Detar Karaburun–Sazan, duke vendosur themelet për një qasje të standardizuar në monitorimin mjedisor të zonave të mbrojtura detare dhe bregdetare.



Më shumë informacion mbi teknologjinë:

- Hanna Instruments – Portable Multiparameter Meters <https://www.hannaservice.eu/>
- <https://www.ysi.com/exo>
- <https://www.ott.com/products/water-quality-sensors-1462/>

Integrimi i sondave multiparametrike, si fikse ashtu edhe të lëvizshme, përfaqëson një hap të domosdoshëm drejt profesionalizimit të praktikave të monitorimit mjedisor në Shqipëri dhe përmbushjes së standardeve kombëtare dhe ndërkombëtare. Kjo qasje forcon mekanizmat për mbrojtjen e burimeve ujore dhe rrit efikasitetin e menaxhimit të biodiversitetit në zonat e mbrojtura.

